

## Shënimet e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në Lek)

## Pasqyra e konsoliduar e Fluksit të Mjeteve Monetare

## Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitim / Humbja e vitit	651,800,502	401,619,117
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	-	690,196
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	504,232,248	470,884,277
Shpenzime zhvleresimi	9,278,776	95,870,337
Të ardhura të përlogaritura mbi vlerën e investimit të kryer	(1,922,649,885)	(1,232,152,579)
Shpërndarja e kuotës pjesë e të ardhurave të përlogaritura me pare për vlerën e investimit të kryer	531,350,842	232,531,088
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(16,455,595)	4,640,385
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(142,479,531)	223,424,055
Rënie/(rritje) në inventarë	172,730,059	(127,612,411)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme dhe të tjera	617,867,277	274,274,819
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	(175,170,193)	(39,785,529)
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	693,342,263	1,307,056
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>923,846,763</b>	<b>305,690,811</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(628,898,016)	(664,430,307)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	21,405,416	13,343,600
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata jomateriale	(805,493,658)	(92,336,567)
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera	-	(50,001)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>	<b>(1,412,986,258)</b>	<b>(743,473,275)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
Kontribut në kapital nga interesat jo-kontrolluese (Ripagim)/ të hyra nga qera financiare	153,282,775	30,115,928
Ripagim/ të hyrat neto nga huatë afatgjata	702,853,192	(18,466,661)
Dividende të paguar	(100,000,000)	147,111,540
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>	<b>756,135,967</b>	<b>158,760,807</b>
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	266,996,473	(279,021,657)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	303,325,915	582,347,572
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>570,322,387</b>	<b>303,325,915</b>

Pasqyrat Financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 36 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## 1. Informacion i përgjithshëm

“Salillari”, sh.p. k është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar me datë 10.08.1994, në përputhje me ligjin “Për shoqëritë tregtare” dhe statuti i saj. Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj dhe ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Kompani mëme Salillari shpk zotëron:

- 100% shoqërinë Hydro -Salillari shpk me Nipt L118100080 themeluar më 10.06.2011
- 50% shoqërinë Albanian Highway Concession (AHC) me Nipt L62427021G themeluar më 27.12.2016.

Shoqëria Salillari ka vlerësuar se ka kontroll mbi shoqërin AHC.

Pasqyrat Financiare paraqiten të konsoliduara me kompanite Hydro Salillari dhe Albanian Highway Concession.

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë Salillari është realizimi i ndërtimeve me karakter civil, industrial, tregtar, tregtim dhe prodhim i materialeve të ndërtimit, infrastrukturës rrugore etj. Projektim , zbatim , mirëmbajtje të sistemeve elektike, të impianteve për HEC etj.

Shoqëria “Albanian Highway Concession” sh.p.k. është një shoqëri e themeluar në përmbushje të kushteve e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Konçesionit për “Ndërtimin, Përmirësimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Autostradës Milot-Morinë”, nënshkruar me datë 6 Dhjetor 2016 ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës si Autoriteti Kontraktor (sot, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) si dhe Bashkimit të Shoqërive "Catalyst Viva Das General Contracting & Salillari Sh.p.k & Violiap & Bee Tech & Kastrati Sh.A" Si Konçesionari.

Objekti i kësaj Marrëveshjeje është “Ndërtimi, përmirësimi, operimi (duke përfshirë vjeljen e taksave të rrugës) dhe mirëmbajtja e autostradës Milot-Morinë”.

Periudha e konçesionit fillon në Datën e hyrjes në fuqi dhe përfundon në datën e përfundimit të tij (“Periudha e Konçesionit”). Në varësi të përfundimit të parakohshëm të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me kushtet e saj, Periudha e Konçesionit do të jetë 30 (tridhjetë) vjet.

Shoqëria Hydro Salillari operon në përputhje me Marrëveshjen e Konçesionit date 18 Maj 2009 e formes BOT, Ndërtim, operim dhe transferim për një periudhë 35 vjecare. Objekti i kësaj Marrëveshjeje është “Ndërtimi, përmirësimi dhe operimi i hidrocentralit në Vertop Berat.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë Salillari është 1,381,548,000 Lekë.

Në 31 dhjetor 2021 shoqëria ka 952 punonjës. (2020: 854).

## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

### 2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat Financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### 2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat Financiare të konsoliduara janë përgatitur bazuar në koston historike.

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**

### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat Financiare të konsoliduara të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

### **2.5. Bazat e konsolidimit**

Filialet janë të gjitha subjektet (duke përfshirë njësitë ekonomike për qëllime të veçanta) mbi të cilat Grupi ka fuqi për të qeverisur politikat financiare dhe operative, që në përgjithësi u atribuohen aksionereve që zotërojnë më shumë se gjysmën e të drejtave të votës. Ekzistenca dhe efekti i të drejtave votuese potenciale që janë aktualisht të ushtrueshme ose të konvertueshme janë konsideruar kur është bërë vlerësimi nëse Grupi kontrollon një njësi tjetër ekonomike. Filialet janë konsoliduar plotësisht që nga data në të cilën kontrolli i është transferuar Grupit. Metoda e kostos është përdorur për të kontabilizuar blerjen e filialeve nga Grupi. Kostoja e blerjes është matur në vlerën e drejtë të aktiveve të dhëna, instrumentave të kapitalit neto të emetuara dhe detyrimeve të pësuara ose konstatuara në datën e këmbimit, plus kostot direkte të blerjes. Aktivitetet e identifikueshme të blera dhe detyrimet e konstatuara në një kombinim biznesi njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën e blerjes, pavarësisht nga interesi i pakicës.

Tejkalimi i kostos së blerjes mbi vlerën e drejtë të pjesës të grupit të aktiveve neto të identifikueshme njihet si emri i mirë. Transaksionet midis shoqërive të grupit, balancat dhe fitimet e përealizuara për transaksione ndërmjet shoqërive të grupit janë eliminuar. Gjithashtu janë eliminuar humbjet e përealizuara. Politikat kontabël të filialeve janë ndryshuar kur ka qenë e nevojshme për t'u përputhur me politikat e miratuara nga Grupi.

### **2.6. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Informacionet në lidhje me zonat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël të cilat më së shumti ndikojnë në paraqitjen e shumave në Pasqyrat Financiare të konsoliduara, janë paraqitur në shënimin nr.4.

### **3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)**

#### **3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale**

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 janar 2021, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

- Konçensione të lidhura me qiratë në kushtet e COVID-19 përtej 30 qershor 2021 (Ndryshime në SNRF 16)
- Reforma e Referencës së Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7 Faza 2)

#### **3.2. Standardet dhe interpretimet të lëshuara, por ende nuk janë adoptuar**

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standarde dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë këto standarde dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur më 31 dhjetor 2021:

- Kontratat me kushte – Kostoja e përbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37) – Në fuqi nga 1 janari 2022
- Aktive afatgjatë materiale: Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16) - Në fuqi nga 1 janari 2022
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve SNRF 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41) - Në fuqi nga 1 janari 2022
- Referencat në Kuadrin Konceptual (Ndryshimet në SNRF 3). Në fuqi nga 1 janari 2022
- Dhënia e shënimeve shpjeguese të politikave kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës IFRS 2) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimet në SNK 8) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet në SNK 12) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- SNRF 17 – Kontratat e Sigurimeve – Në fuqi më 1 janar 2023

#### **4. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në Pasqyrat Financiare të konsoliduara.

##### **4.1 Të ardhurat nga kontratat dhe fitimi**

Kompania njeh të ardhurat kur përbush kushtet e performancës gjatë kohës vetëm nëse ajo mat në mënyrë të arsyeshme progresin kundrejt përbushjes së plotë të kushteve të performancës. Kontrata me klientin konsiderohet si një kusht i vetëm performance.

Kompania njeh të ardhurat duke përdorur metodën e kostos plus marzhin kur kostoja është vlerësuar duke përdorur metodën input për njohjen e të ardhurave.

(Vlerat janë në Lek)

**4. Politikat Kontabël (vazhdim)****4.1 Të ardhurat nga kontratat dhe fitimi (vazhdim)**

Kompania përjashton nga metoda input efektin e çdo malli apo shërbimi për të cilin ajo nuk transferon kontroll tek klienti.

Kompania konsideron kushtet e kontratës dhe ka përcaktuar çmimin e transaksionit bazuar në vlerën e kontratës. Çmimi i transaksionit është shuma korresponduese për të cilën pret të ketë të drejtë një njësi ekonomike në këmbim të transferimit tek klienti të mallrave apo shërbimeve të premtuara, duke përjashtuar shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta (për shembull, taksat mbi shitjen).

Në shoqërinë AHC, të ardhurat përlllogariten mbi vlerën e investimit të kryer. Shuma e të ardhurave, në përputhje me SNRF 15, përfaqëson vlerën e tregut, të investimit të kryer i cili do të shlyhet kompanisë konçesionare në vitet e ardhshme nëpërmjet tarifave që do të arkëtohen nga përdorimi i rrugës në vitet në vijim.

Supozimet e rëndësishme dhe gjykimet lidhur me SNRF 15 janë paraqitur në shënimin 4.

**4.2 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Euro/LEK	120.76	123.70
USD/ LEK	106.54	100.84

**4.3 Instrumentat financiarë**

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

**Instrumentat financiare – njohja fillestare.** Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

**Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes.** Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivitetit.

#### 4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

##### 4.3 Instrumentat financiarë (vazhdim)

**Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit.** Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrë se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

**Aktivitetet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare.** Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 4 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

**Aktivitetet financiare – pakësimi i vlerës.** Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

**Aktivitetet financiare - çregjistrimi.** Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivitetit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

*(Vlerat janë në Lek)***4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)****4.3 Instrumentat financiarë (vazhdim)**

**Detyrimet financiare – kategorite e matjes.** Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

**Detyrimet financiare – çregjistrimi.** Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhen (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

**Kompensimi i instrumenteve financiare.** Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

***Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre***

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

***Llogari të arkëtueshme***

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionin për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

(Vlerat janë në Lek)

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **4.3 Instrumentat financiarë (vazhdim)**

###### *Llogaritë e pagueshme*

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

###### *Huatë*

Huatë janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive.

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së koston së amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skanton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar, ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

###### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

###### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

###### *Kapitali*

Kapitali i nenshkruar njihet me vlerën nominale.

###### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **4.4 Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

##### **4.5 Prodhimi në proces**

Prodhimi në proces në kontratat afatgjata llogaritet me kosto plus fitimin që i atribuohet, në masën që është e arsyeshme me pas krijimi provizioneve për kontigjencat, minus ndonjë humbje të ndodhur ose të parashikuar për të sjellë kontratat drejt perfundimit dhe minus shumat e arkëtuara ose për tu arkëtuar si pagesa në progres. Për këtë arsye, kostot përfshijnë të gjitha kostot direkte të kontratave. Për cdo kontratë kur arkëtimet plus të arkëtueshmet tejkalojnë vlerën kontabël të punës së kryer diferenca e shtuar përfshihet në llogaritë e pagueshme dhe të shtyrat.

##### **4.6 Aktive afatgjata materiale**

###### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

###### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

###### *iii. Amortizimi*

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivitetit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)****4.6 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)**

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Toka		Nuk amortizohet
Ndërtesa dhe instalime	Vlera e mbetur	5 %
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Instalimet	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Mobilje e orendi	Vlera e mbetur	20 %

Këto norma reflektojnë më së shumti vlerën e pritshme të konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike që burojnë nga aktivet afatgjata materiale. Prodhimi në proces nuk amortizohet. Normat e amortizimit dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në çdo datë raportimi.

*iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

**4.7 Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16)**

Njësia ekonomike vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në fillim të kontratës. Një qira përmban të drejtën për të përfutur përdorimin dhe për të marrë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike të një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të flukseve dalese.

Në datën e fillimit të qirasë, njësia ekonomike njih një aktiv me të drejtë përdorimit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike. Aktivi i së drejtës së përdorimit matet me kosto, i cili përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga njësia ekonomike, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të qirasë, dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo zbritje e marrë). Njësia ekonomike zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në më të hershmen midis fundit të jetës së dobishme të aktivit me të drejtë përdorimi dhe afatit të qirasë. Njësia ekonomike gjithashtu zhvlerëson aktivin me të drejtë përdorimi kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, njësia ekonomike mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, e skontuar me normën shtesë të huamarrjes së njësisë ekonomike, pasi që kontratat e qirasë negociohen me palët e treta nuk është e mundur të përcaktohet norma e interesit që nënkuptohet në qira.

Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që njësia ekonomike duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë gjatë një afati të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet të cilat kanë një bazë të arsyeshme që do të ushtrohen.

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **4.7 Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16) (vazhdim)**

Pas matjes fillestare, pasivi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që shpërndahen midis ripagimeve të principalit dhe kostove financiare. Kostoja financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesëshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. Aktivi i së drejtës së përdorimit rregullohet për të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

Njësia ekonomike ka zgjedhur të regjistrojë qira afatshkurtra dhe qira të aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur përshtatjet praktike. Në vend që të njohim një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe detyrimin e qirasë, pagesat në lidhje me to njihen si një shpenzim në fitim ose humbje mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

Norma e interesit të huamarrjes e aplikuar në detyrimet e qerasë me 1 janar 2019 ishte 5.41 % për kontratën e qerasë në euro.

##### **4.8 Kosto e huamarrjes**

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin të aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve. Kostot e huamarrjes kanë të bëjnë me interesin dhe kosto të tjera që janë bërë nga një shoqëri në lidhje me marrjen e fondeve. Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

##### **4.9 Provizione**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

##### **4.10 Trajtimi kontabël për marreveshjen e konçesionit**

Shoqëria AHC ka aplikuar KIRNF 12 për njohjen e kontrates së konçesionit. Shërbimet e ndërtimit ose të përmirësimit janë njohur në përputhje me kërkesat e SNRF 15/(SNK 11) me vlerën e tyre të drejtë. Nga ana tjetër shoqëria ka njohur një aktiv financiar pasi ajo plotëson kushtet e paragrafit 15 të KIRNF 12 sipas të cilit:

Operatori do të njohë një aktiv financiar në masën që ai ka një të drejtë kontraktuale të pakushtëzuar për të arkëtuar mjete monetare ose një aktiv financiar tjetër nga ose me urdhër të koncesiondhënësit për shërbimet e ndërtimit; koncesion dhënësi ka pak, ose nuk ka, mundësi të mos paguajë, sepse zakonisht marreveshja është e detyrueshme me ligj. Operatori ka një të drejtë të pakushtëzuar të arkëtojë mjete monetare nëse koncesion dhënësi garanton kontraktualisht t'i paguajë operatorit (a) shuma të specifikuar ose të përcaktueshme apo (b) diferencën, nëse ka, midis shumave të arkëtuara nga përdoruesit e shërbimit publik dhe shumave të specifikuar ose të përcaktueshme, madje edhe kur pagesa është në varësi të plotësimin të kërkesave nga operatori për cilësinë ose efikasitetin e specifikuar të infrastrukturës.

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **4.10 Trajtimi kontabël për marreveshjen e konçesionit (vazhdim)**

Ne baze të interpretimeve të BSNK, shuma e garantuar mund të paguhet nga përdoruesit e rruges apo nga autoriteti kontraktues. Metoda e pagesës konsiderohet një çështje forme pasi shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar kontraktuale për të arkëtuar para.

KIRNF 12 kërkon gjithashtu që operatori duhet të njohë një aktiv jo-material në masën që i jep atij të drejtën (licencën) për t'i tarifuar përdoruesve të shërbimit publik. Një e drejtë për t'ia faturuar shpenzimet përdoruesve të shërbimit publik nuk është një e drejtë e pakushtëzuar për të arkëtuar mjete monetare, sepse shumat janë në varësi të shkallës së përdorimit të shërbimit nga publiku. Në modelet e saj të parashikimit shoqëria ka parashikuar trafikun deri në nivellin e të ardhurave të garantuara.

Shoqëria Hydro Salillari ka aplikuar IFRIC 12 për njohjen e kontrates së konçesionit.

Ne baze të marreveshjes konçesionare me ministrinë e Energjitikës, Hydro Salillari është kontraktuar si operator privat për të ndërtuar (ose përmirësuar), përdorur dhe mirëmbajtur rrjete të shpërndarjes së energjisë. Në këtë marrëveshje, konçesiondhënësi kontrollon ose rregullon çfarë shërbimesh duhet të ofrojë operatori duke përdorur aktivet, kujt duhet t'ia sigurojë dhe me çfarë çmimi, dhe gjithashtu kontrollon çdo interes të mbetur domethënës në aktive në fund të afatit të marrëveshjes.

Shoqëria ka njohur aktivet e krijuara nga marrëveshja konçesionare sipas modelit të Aktivit Jomaterial. Operatori duhet të njohë një aktiv jo-material në masën që i jep atij të drejtën (licencën) për t'ia tarifuar përdoruesve të shërbimit publik. Operatori duhet fillimisht të masë aktivin jo-material me vlerën e drejtë. Më tej për kontabilizimin e aktivit jomaterial, operatori duhet të zbatojë kërkesat e IFRIC 12 Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale.

##### **4.11 Përfitimet e punëmarrësve**

###### *Kontributet e detyrueshme shoqërore*

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shumat të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzimi përfitimit të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

##### **4.12 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për fondet e depozituara në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit, humbjet nga kurset e këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi të njohura në aktivet financiar

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **4.13 Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital apo në të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme. Normat e tatimit për vitin 2021 është 15% (2020: 15%).

Tatimi i shtyrë njihet duke paraqitur diferencat e përkohshme midis vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv për tatimin e shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhura të tatueshme të ardhshme do të realizohen kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme të realizohen përfitime tatimore të lidhura me të.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit të periudhës dhe tatimit të shtyrë Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e pasigurtë të pozicionit të taksave dhe nëse mund të ngarkohen taksa shtesë ose interesa. Shoqëria beson se shpenzimet e përlogaritura të saja për detyrimet tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet tatimore të hapura bazuar në vlerësimin e saj për shumë faktorë, duke përfshirë interpretime të ligjit të taksave dhe përvojave të mëparshme. Ky vlerësim mbështetet nëparashikime dhe supozime dhe mund të përfshijë një seri gjykimesh për ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja mund të bëhen të disponueshme duke ndikuar në ndryshimin e vendimit të Shoqërisë në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të ndikojë në shpenzimet tatimore në periudhën që është bërë një përcaktim i tillë.

##### **4.14 Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

##### **4.15 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në Pasqyrat Financiare të konsoliduara. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare të konsoliduara për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në Pasqyrat Financiare të konsoliduara por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

## 5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një-sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

### *Njohja e të ardhurave*

Më poshtë listohet gjykimet e bëra në aplikimin e SNRF 15 që kanë ndikim të rëndësishëm në përcaktimin e shumës dhe kohës së njohjes së të ardhurave nga kontratat me klientet.

Shoqëria plotëson kriteret e SNRF 15 paragrafi 35 për njohjen e të ardhurave përgjate kohës së kontratës. Këto kriterë përfshijnë:

- Aktiviteti i Shoqërisë krijon ose përmirëson në aktiv (për shëmbull, punim në proces) i cili kontrollohet nga klienti gjatë kohës që ai krijohet apo përmiresohet.
- Aktiviteti i Shoqërisë nuk krijon ndonjë aktiv që mund të përdoret ndryshe dhe shoqëria ka një të drejtë të ekzekutueshme me forcë për t'u paguar lidhur me performancën e realizuar deri në atë datë.

Shoqëria njeh të ardhurat që lidhen me kushtet e performancës të përmbushura në kohë vetëm nëse ajo mund të masë në mënyrë të arsyeshme progresin ndaj realizimit të plotë të kushteve të performancës.

Kontrata me klientin trajtohet si një kusht i vetëm performance.

Shoqëria njeh të ardhurat duke përdorur metodën e perqindjes së realizimit ku kosto përcaktohet sipas metodës input të njohjes së të ardhurave. Shoqëria përjashton nga metoda input efektet e çdo inputi që nuk paraqet performancën e njësisë ekonomike në transferimin e kontrollit të mallrave apo shërbimeve tek klienti.

Kompania konsideron kushtet e kontratës dhe ka përcaktuar çmimin e transaksionit bazuar në vlerën e kontratës. Çmimi i transaksionit është shuma korresponduese për të cilën pret të ketë të drejtë një njësi ekonomike në këmbim të transferimit tek klienti të mallrave apo shërbimeve të premtuara, duke përjashtuar shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta (për shëmbull, taksat mbi shitjen). Në përcaktimin e cmimit të transaksionit merren në konsideratë:

- shumën korresponduese të ndryshueshme
- kufizimin në vlerësimet e shumës së ndryshueshme
- ekzistencën e një përbërësi financues të rëndësishëm në kontratë
- shumën korresponduese jo monetare
- shumën korresponduese të pagueshme ndaj klientit

## 5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)

### *Tatimi mbi fitimin*

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatimit fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumatat të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatimit fitimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

### *Trajtimi i kontratës së koncesionit*

Shërbimet e ndërtimi ose të përmirësimit janë njohur në përputhje me kerkesat e SNK 11 me vlerën e tyre të drejtë. Vlera e drejtë është përlogaritur si shuma që shërbimi i ndërtimit do të shitej si një detyrim i pavarur i kontratës së koncesionit. Shoqëria ka rishikuar modelin e saj financiar në bazë të rezultateve faktike deri në momentin e aprovimit të pasqyrave financiare. Për pasojë, shoqëria ka njohur një aktiv financiar deri në masën e të ardhurave të pritshme të garantuara dhe një aktiv afatgjatë jomaterial për shumën e trafikut të parashikuar mbi vlerën e garantuar. Për pasojë shoqëria ka trajtuar kontratën e koncesionit në përputhje me modelin hibrid të KIRNF 12.

### *Vlerësimi i modelit të biznesit*

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Llogaritje e arketueshme të kompanisë përfshijnë vetëm një dalje të mjeteve monetare, pagesën e vlerës që rezultojnë nga transaksioni në lidhje me SNRF 15, i cili konsiderohet të jetë kryesor. Prandaj, daljet e mjeteve monetare nga llogaritje e arketueshme janë në përputhje me modelin e biznesit pavarësisht komponentit të interesit duke qenë zero.

**6. Aktive Afatgjata Materiale**

Aktivet Afatgjata Materiale më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 janë si më poshtë:

Kosto	Toka Terrene	Ndortesa	Makineri/dhe Pajisje	Te tjera Instalime dhe pajisje	Mjete transporti	Pajisje Informatike	Mobiljo e pajisje zyre	Parapagime per aktive materiale dhe ne proces	Asete ne perdorim (IFRS 16)	Te tjera Asete	Totali
Gjendja më 1 janar 2020	201,450,160	907,280,649	1,460,194,076	252,419,815	1,436,285,625	105,674,966	111,262,965	21,617,448	4,583,808	-	4,502,669,512
Shtesa	843,200	31,785,996	345,929,287	3,640,959	218,950,335	48,268,830	15,014,701	-	-	-	664,430,307
Transferime	-	-	21,617,448	-	-	-	-	(21,617,448)	-	-	-
Pakësimet	(36,580,000)	(101,738,890)	(7,164,542)	-	(28,274,287)	-	-	-	-	-	(173,757,719)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>165,713,360</b>	<b>837,327,755</b>	<b>1,820,576,269</b>	<b>256,060,774</b>	<b>1,628,961,673</b>	<b>153,840,796</b>	<b>126,277,666</b>	<b>-</b>	<b>4,583,808</b>	<b>-</b>	<b>4,993,342,100</b>
Shtesa	36,881,000	-	496,859,489	3,113,483	65,998,017	19,672,772	6,363,255	-	-	-	628,896,015
Transferime	-	-	(58,887,723)	(197,380,131)	-	(9,039,449)	(64,307,995)	-	-	73,347,444	(256,267,954)
Pakësimet	-	-	(74,739,399)	(353,333)	(7,644,760)	(8,047,892)	(19,404,498)	-	-	-	(110,189,873)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>202,604,360</b>	<b>837,327,755</b>	<b>2,183,808,636</b>	<b>61,440,792</b>	<b>1,687,314,930</b>	<b>156,426,228</b>	<b>48,929,437</b>	<b>-</b>	<b>4,583,808</b>	<b>73,347,444</b>	<b>5,255,782,388</b>
<i>Amortizimi i kumuluar</i>											
Gjendja më 1 janar 2020	-	195,071,257	976,776,675	190,296,498	636,145,953	43,315,191	40,857,774	-	611,150	-	2,043,074,498
Amortizimi i vitit	-	30,013,782	150,689,775	16,242,365	192,827,313	17,577,581	14,999,766	-	916,762	-	422,167,344
Pakësimet	-	(218,595)	(3,944,293)	-	(12,791,868)	-	-	-	-	-	(16,954,856)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>-</b>	<b>224,868,444</b>	<b>1,123,422,157</b>	<b>165,538,863</b>	<b>816,181,298</b>	<b>60,892,772</b>	<b>55,857,540</b>	<b>-</b>	<b>1,527,912</b>	<b>-</b>	<b>2,448,286,886</b>
Amortizimi i vitit	-	29,303,400	190,057,315	13,205,518	166,242,372	20,879,467	4,738,477	-	916,787	8,920,042	434,266,379
Transferime	-	-	(30,062,507)	(134,363,796)	-	(9,964,933)	(4,174,360)	-	-	-	(164,426,303)
Pakësimet	-	-	(72,739,052)	(329,120)	(2,780,808)	-	-	-	-	26,415,745	(101,145,438)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>-</b>	<b>254,169,844</b>	<b>1,210,677,913</b>	<b>44,054,465</b>	<b>979,642,862</b>	<b>71,807,407</b>	<b>18,849,648</b>	<b>-</b>	<b>2,444,699</b>	<b>35,335,787</b>	<b>2,616,981,624</b>
<i>Vlera neto kontabël</i>											
Gjendja më 31 dhjetor 2020	165,713,360	612,461,311	697,154,112	90,521,910	812,780,375	92,948,024	70,420,126	-	3,055,896	-	2,545,055,114
Gjendja më 31 dhjetor 2021	202,604,360	583,157,911	973,130,723	17,386,327	707,672,068	84,618,821	30,079,789	-	2,139,109	38,014,657	2,638,800,768

**7. Aktive afatgjata jomateriale**

Aktivet Afatgjata Jomateriale më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 janë si më poshtë:

	Total konçension	Të tjera AAJM	Total
<b>Kosto</b>			
Gjendja më 1 janar 2020	1,314,691,425	1,814,344	1,316,505,769
Shtesa	91,403,942	932,625	92,336,567
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>1,406,095,367</b>	<b>2,746,969</b>	<b>1,408,842,336</b>
Shtesa	805,478,341	15,317	805,493,658
Pakësime	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>2,211,573,708</b>	<b>2,762,286</b>	<b>2,214,335,994</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>			
Gjendja më 1 janar 2020	79,671,550	371,253	80,042,803
Amortizimi i vitit	48,467,680	249,254	48,716,934
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>128,139,230</b>	<b>620,507</b>	<b>128,759,737</b>
Amortizimi i vitit	65,710,717	320,501	66,031,218
Pakësime	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>193,849,947</b>	<b>941,008</b>	<b>194,790,955</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>			
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>1,277,956,137</b>	<b>2,126,462</b>	<b>1,280,082,599</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>2,017,723,761</b>	<b>1,821,278</b>	<b>2,019,545,039</b>

**8. Emri i mirë**

Emri i mirë është krijuar nga marrja e kontrollit të shoqërisë AHC në vitin 2017 si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Emri i mirë	29,296,875	29,296,875
	<b>29,296,875</b>	<b>29,296,875</b>

**9. Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara**

Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Pjesëmarrje ne kompanine Albania Treatment Company 50%	50,000	50,000
Pjesëmarrje ne kompanine Porti BMB 1%	-	1
	<b>50,000</b>	<b>50,001</b>

**10. Inventari**

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Materiale dhe lende e pare	66,841,259	154,610,824
Mallra dhe produkte te gatshme	22,478,048	22,951,633
Materiale të tjera dhe ndihmese	41,090,267	23,971,191
Inventar i imet	-	9,764,435
	<u><b>130,409,574</b></u>	<u><b>211,298,083</b></u>

**11. Llogaritë të arkëtueshme tregtare**

Llogaritë e arkëtueshme afatshkurtra më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Klientet	3,353,601,522	1,812,259,335
Zhvlerësimi llogarive të arkëtueshme	(105,149,113)	(95,870,337)
Autoriteti Kontraktues	1,968,123,635	1,901,785,549
	<u><b>5,216,576,044</b></u>	<u><b>3,618,174,547</b></u>

**12. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura**

Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Salillari Construction	3,727,200	2,347,200
Bervi Security	-	12,600
	<u><b>3,727,200</b></u>	<u><b>2,359,800</b></u>

**13. Llogari të arkëtueshme të tjera**

Llogari të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
TVSH e kreditueshme	236,357,694	358,093,148
Të tjera tatime dhe taksa	2,713,731	596,047
Te tjera te arketueshme	82,811,046	38,462,375
	<u><b>321,882,471</b></u>	<u><b>397,151,570</b></u>

**14. Parapagime dhe shpenzime të shtyra**

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Parapagime për furnizime	307,847,234	100,778,740
Shpenzime të shtyra	28,680,685	60,578,986
	<u><b>336,527,919</b></u>	<u><b>161,357,726</b></u>

**15. Mjete monetare në arkë e në bankë**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Likuiditete në bankë	555,682,716	291,253,663
Likuiditete në arkë	14,639,671	12,072,252
	<u><b>570,322,387</b></u>	<u><b>303,325,915</b></u>

**16. Kapitali**

Vlera e kapitalit të nënshkruar më 31 dhjetor 2021 është 1,381,548,000 lekë i ndarë në 1,381,548 kuota, secila me vlerë 1,000 lekë dhe zotërohen nga Z.Pëllumb Salillari.

Rezerva ligjore është në vlerën e 14,283,062 lekë për të dyja vitet.

Fitimi për vitin ushtrimor deri më 31 dhjetor 2021 është 613,531,992 lekë. (2020: 380,390,526 lekë), ndërsa fitimi i akumuluar deri më 31 dhjetor 2021 është 1,263,474,643 lekë. (2020: 1,254,343,274 Lekë)

**17. Hua afatgjata**

Huatë afatgjata paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Hua afatgjata	2,029,975,598	1,396,779,166
Shpenzime të shtyra-komisione disbursimi huaje	(16,149,543)	(11,200,014)
	<u><b>2,013,826,055</b></u>	<u><b>1,385,579,152</b></u>

**18. Detyrime të tjera afatgjata**

Detyrmet e tjera afatgjata afatgjata detajohen si më poshtë për 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Detyrime ndaj ortakut	511,460,324	416,973,304
Detyrime ndaj Bervi Security	84,618,200	40,313,150
Detyrime të tjera afatgjata	7,771,266	7,918,266
	<u><b>603,849,790</b></u>	<u><b>465,204,720</b></u>

**19. Detyrime për qira financiare**

Detyrmet për qira financiare detajohen si më poshtë për 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Detyrime afatgjata për Leasing	26,524,358	51,563,493
Pjesa afatshkurtër e qirasë financiare	203,550,665	25,228,755
	<u><b>230,075,023</b></u>	<u><b>76,792,248</b></u>

**20. Hua afatshkurtra**

Huatë afatshkurtra detajohen si më poshtë për 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Pjesa afatshkurter e huase afatgjatë	167,303,673	87,620,834
Interesa të maturuar, hua afatgjatë	10,729,527	15,806,077
	<u><b>178,033,200</b></u>	<u><b>103,426,911</b></u>

**21. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Llogari të pagueshme tregtare	2,532,193,421	2,080,273,668
	<u><b>2,532,193,421</b></u>	<u><b>2,080,273,668</b></u>

**22. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura**

Llogaritë e pagueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Kastrati shpk	9,316,302	-
Bervi Security	60,600,000	50,480,000
Salillari Construction	40,301,511	1,032,847
<b>Total llogari te pagueshme tregtare</b>	<b>110,217,813</b>	<b>51,512,847</b>
Kastrati Group	10,090,983	-
Detyrime per dividend	885,630,870	1,017,711,000
	<b>895,721,853</b>	<b>1,017,711,000</b>
<b>Total llogari të pagueshme të tjera</b>	<b>1,005,939,666</b>	<b>1,069,223,847</b>

**23. Parapagimet nga klientë (e arkëtuara)**

Parapagimet nga klientët për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Parapagime nga klientë	697,291,204	3,948,941
	<b>697,291,204</b>	<b>3,948,941</b>

**24. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	18,275,736	15,088,768
Detyrime për tatim page	1,594,326	1,348,204
Detyrime per TVSH	104,023,880	34,178,855
Detyrime per tatimin ne burim	3,530	3,530
Detyrime te tjera	1,325,574	614,008
	<b>125,223,046</b>	<b>51,233,365</b>

**25. Llogari të pagueshme të tjera**

Llogaritë e tjera të pagueshme më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Paga për t'u paguar	49,547,595	42,953,542
Të tjera detyrime	4,467,160	16,546,263
	<b>54,014,755</b>	<b>59,499,805</b>

**26. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Shitje punimeve dhe sherbimeve	4,618,531,059	2,441,081,377
Shitje e produkteve te gatshme	312,334,219	256,163,753
TE ardhura nga shitja e energjise	21,468,958	20,149,440
Të ardhurat e arkëtuara nga tarifa e ndertimit dhe përdorimit të rrugës	1,021,851,082	996,182,434
Të ardhura të përlllogaritura mbi vlerën e investimit të kryer në ndërtim	1,922,649,885	1,232,152,579
	<u><b>7,896,835,203</b></u>	<u><b>4,945,729,583</b></u>

**27. Të ardhura të tjera**

Të ardhurat e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Sherbime shtesë dhënë Autoritetit Kontraktues	47,119,730	-
Të ardhura nga qeraja	7,202,215	5,382,889
Te ardhura nga shitja AAM	16,455,595	-
Te ardhura nga prodhimi i aktiveve	-	31,785,997
Shitje materiale ndihmese	5,943,379	22,188,425
TE ardhura te tjera	68,599,077	20,164,744
	<u><b>145,319,996</b></u>	<u><b>79,522,055</b></u>

**28. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme**

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Lëndë e parë	3,504,706,412	2,172,426,525
Punime nga nenkontrator	1,649,717,188	397,488,779
Mallra	18,694,838	19,588,583
Lëndë ndihmëse	237,980,770	294,940,949
Lëndë djegëse	25,132,578	30,396,039
Mirëmbajta rutine dhe dimërore	51,803,011	6,546,032
Energji për tunelin	13,200,000	26,849,981
Inxhinier i pavarur	42,923,000	55,265,500
Të tjera	99,703,085	40,135,656
	<u><b>5,643,860,882</b></u>	<u><b>3,043,638,044</b></u>

**29. Shpenzime personeli**

Shpenzimet për personelin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Shpenzime për paga	181,293,661	502,225,145
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	543,927,098	81,205,534
	<u><b>725,220,759</b></u>	<u><b>583,430,679</b></u>

**30. Shpenzime të tjera**

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Mirëmbajtje dhe riparime	10,398,327	19,757,856
Shpenzime transporti personeli e të tjera	2,969,358	657,478
Sigurime	49,295,692	44,141,279
Udhëtime e dieta	114,800,672	46,912,189
Shpenzime ligjore e konsulenca	1,112,850	2,391,872
Shërbime nga të tretë	32,716,671	8,307,120
Shpenzime administrative	5,820,552	6,354,161
Shpenzime marketingu	100	12,196,000
Shpenzime telefon dhe internet	2,379,821	4,084,747
Shpenzim kreditimi te pjesshem	17,431,370	8,519,142
Tatime dhe taksa vendore	9,848,150	7,456,894
Tarife dhe taksa te tjera	25,237,895	16,018,058
Gjoha e dëmshpërblime	11,206,530	172,569
Humbje nga shitje e aktiveve	-	4,640,385
Komisione dhe tarifa bankare	22,300,001	6,955,102
Sherbime doganore	2,039,777	2,020,010
Qera	3,741,707	552,130
Të tjera shpenzime	31,138,425	66,616,217
	<u><b>342,437,898</b></u>	<u><b>257,753,209</b></u>

**31. Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)**

Shpenzimet interesi dhe të ngjashme (neto) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Shpenzime për interesa	(69,581,531)	(74,031,652)
Te ardhura nga interesat KIRFN 12	103,217,515	74,770,729
Shpenzime interesi SNRF 16	(149,486)	(199,284)
	<u><b>33,486,498</b></u>	<u><b>539,793</b></u>

**32. Shpenzime të tjera financiare (neto)**

Shpenzimet të tjera financiare (neto) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Të ardhura/(shpenzime) nga kembimet valutore neto	76,730,965	80,594,983
	<u><b>76,730,965</b></u>	<u><b>80,594,983</b></u>

**33. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin**

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
<b><i>Fitimi para tatimit</i></b>	<b>773,880,169</b>	<b>493,619,902</b>
Total shpenzime të panjohura	22,949,471	103,710,332
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	11,206,530	1,396,847
Shpenzime pritje-percjellje	-	936,820
Amortizim mbi normat fiskale	-	4,640,365
Shpenzime interes	747,100	-
Shpenzim qiraje Financiare	457,199	-
Zhvleresim klientesh	9,278,776	95,870,337
Shpenzime të tjera	1,259,866	865,963
<b><i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i></b>	<b>796,829,640</b>	<b>597,330,234</b>
<b><i>Tatim fitimi @15%</i></b>	<b>122,079,667</b>	<b>91,310,589</b>
Shpenzim tatim fitimi i shtyre	-	(690,196)
Shpenzim per tatim fitimin	(122,079,667)	(92,000,785)
<b>Fitimi neto për vitin</b>	<b>651,800,502</b>	<b>401,619,117</b>

### 34. Manaxhimi i riskut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi prej saj i instrumentave financiarë:

- risku i kreditit
- risku i likuiditetit
- risku i tregut

Ky shënim paraqet informacionin rreth ekspozimit të shoqërisë ndaj secilit prej risqeve të mësipërme, objektivave të shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe manaximin e riskut dhe manaximin e kapitalit të shoqërisë. Shënime sasiore të tjera janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Drejtimi ka përgjegjësinë e plotë për hartimin dhe mbikqyrjen e kuadrit të manaximit të riskut të shoqërisë.

Politikat e manaximit të riskut të shoqërisë janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar risqet e hasura nga Shoqëria, për të vendosur kontrollet dhe limitet e duhura të riskut dhe për të monitoruar riskun dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e manaximit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve e procedurave të manaximit të saj, ka si qëllim të zhvillojë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit janë në dijeni me rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentat kryesorë financiarë të shoqërisë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

#### (a) Risku i kreditit

Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson shumën maksimale të ekspozimit të rrezikut. Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit. Shoqëria ndjek të drejtat e paarkëtuara në baza periodike.

#### (b) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që kompania të hasë ndonjë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare që likuidohen nëpërmjet parave apo aktiveve të tjera financiare.

Salliarri sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në Lek)

#### 34. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

##### (b) Risku i likuiditetit (vazhdim)

Më poshtë paraqiten aktivet dhe pasivët financiarë sipas maturitetit kontraktual të tyre më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020:

	31 dhjetor 2021			Totali
	Deri në 3 muaj	3-12 muaj	Mbi 1 vit	
<b>Aktive monetare</b>				
Llogari të arkëtueshme tregtare	988,444,877	3,479,658,616	748,472,551	5,216,576,044
Llogari të arkëtueshme palet e lidhura	-	3,727,200	-	3,727,200
Llogari të arkëtueshme të tjera	540,636	264,981,595	56,900,876	322,423,107
Mjete monetare në arkë dhe bankë	570,322,387	-	-	570,322,387
<b>Totali</b>	<b>1,559,307,900</b>	<b>3,748,367,411</b>	<b>805,373,427</b>	<b>6,113,048,738</b>
<b>Detyrime monetare</b>				
Llogari të pagueshme tregtare	1,089,350,041	1,191,839,491	251,003,889	2,532,193,421
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	120,308,796	-	1,481,709,394	1,602,018,190
Detyrime tatimore	161,649,144	-	-	161,649,144
Llogari të pagueshme të tjera	54,014,755	-	7,771,266	61,786,021
Qera financiare	927,766	203,940,519	25,206,738	230,075,023
Hua	10,729,527	167,303,673	2,013,826,055	2,191,859,255
<b>Totali</b>	<b>1,436,980,029</b>	<b>1,563,083,683</b>	<b>3,779,517,341</b>	<b>6,779,581,054</b>
<b>Rreziku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>122,327,870</b>	<b>2,185,283,728</b>	<b>(2,974,143,914)</b>	<b>(666,532,316)</b>